

Prill 2011
gap

monitor

i vendimeve të Qeverisë së Kosovës



- Miratohet Raporti Tremujor i Buxhetit për Vitin 2011
- Ndryshohet traseja e autostradës, në kundërshtim me Ligjin për Planifikim Hapësinor
- Dokumentet personale mund të merren edhe në konsullatat e Kosovës
- Miratohet Projektligji për Mbrojtjen e Dëshmitarëve

Hyrje

Aktivitetet e Qeverisë së Kosovës gjatë muajit prill 2011, kanë qenë më intenzivët që nga tetori i vitit të kaluar. Për shkak krizës institucionale, aktivitetet e Qeverisë ishin minimizuar. Gjatë muajit prill 2011, Qeveria e Kosovës ka mbajtur pesë mbledhje, ku janë marrë gjithsej 32 vendime.

Në këtë muaj janë miratuar një mori projektligjesh të rëndësishme si dhe raporte periodike. E tërë mbledhja 9 e Qeverisë së Kosovës është shfrytëzuar për miratim të projektligjeve, kurse në të gjitha mbledhjet e mbajtura gjatë muajit prill janë miratuar 12 projektligje. Disa nga projektligjet e miratuara në këtë muaj, janë projektligje të cilat vetëm janë riproceduar në Kuvend dhe të cilat kanë mbetur nga mandati i kaluar.

Më 18 prill Qeveria ka miratuar dokumentin më të diskutuar kohëve të fundit – Vizioni i Zhvillimit Ekonomik 2012-2014. Mirëpo, përmbajtja e këtij programi nuk është asgjë më shumë se sa një dokument i shkurtër i prezantuar në “PowerPoint”. Për më tepër, ky program nuk përputhet as me Kornizën Afatmesme të Shpenzimeve 2012-2014, i cili u miratua po këtë muaj.

Për këto dhe vendimet tjera të Qeverisë gjatë muajit prill 2011, lexoni raportin e plotë të GAP Monitor për muajin prill 2011. Gjithashtu, të gjitha vendimet e Qeverisë dhe raportet e GAP për këto vendime janë publikuar në vazhdimësi pas çdo mbledhje të Qeverisë në portalin e GAP Monitor në internet - www.gapmonitor.org.

Përmbajtja

- | | | | |
|---|--|----|---|
| 1 | Qeveria miraton prezantimin në “PowerPoint” të Vizionit për Zhvillim Ekonomik 2011-2014 | 10 | Qeveria fillon përgatitjen e studimit të fizibilitetit për mirëmbajtjen e autostradës Vërmicë-Merdare dhe ndërtimin e autostradës Prishtinë-Hani i Elezit |
| 2 | Ndryshohet traseja e autostradës, në kundërshtim me Ligjin për Planifikim Hapësinor | 11 | Iu vazhdohet pagesa ish pjesëtarëve të TMK-së dhe iu rriten pagat Institutit Albanologjik dhe atij të Historisë |
| 3 | Miratohet KASH 2012-2014 | 12 | Qeveria vazhdon me rimiratimin e projektligjeve të mbetura në procedurë nga mandati i kaluar |
| 4 | Miratohet Raporti Tremujor i Buxhetit për Vitin 2011 | 13 | Dokumenti i Politikave për Kontrollin e Brendshëm të Financave Publike dhe Plani i Veprimi |
| 5 | Miratohet Rregullorja për Koordinimin e Donatorëve | 14 | Miratohet Projektligji për Mbrojtjen e Dëshmitarëve |
| 6 | Qeveria i propozoi Kuvendit ish kryeprokurorin z.Osman Kryeziu për anëtarë në Organin Shqyrtues të Prokurimit | 15 | Miratohet Ndarja e Fondit Shtesë për stimulimin e Prokurorisë Speciale të Kosovës |
| 7 | Dokumentet personale mund të merren edhe në konsullatat e Kosovës | 16 | Miratohet kërkesa e MEF për Ratifikimin e Konventës së Këshillit Botëror të Doganave |
| 8 | Themelohet i Këshillit Konsultativ për Drejtësi dhe Institutit për Hulumtimin e Krimeve të Luftës në Kosovë prej vitit 1990-1999 | 17 | Edhe këtë vit Qeveria mbështeti manifestimet e Ditës Memoriale të Komunitetit Turk në Kosovë |
| 9 | Miratohet vendimi për aplikimin e normës së Tatimit të Akcizës për Lojëra të Fatit | 18 | Për të dytin vit me radhë Qeveria përkrah Festivalin Ndërkombëtar të Poezisë “Drini Poetik” |

Qeveria miraton prezantimin në “PowerPoint” të Vizionit për Zhvillim Ekonomik 2011-2014

• *Prioritetet e Qeverisë parashohin një rritje ekonomike prej 7-8% në vit dhe ulje të papunësisë 8-10%, por pa treguar se si do të arrihet kjo dhe në çfarë sektorësh pritet të punësohen të papunët.*

Në mbledhjen e dhjetë të Qeverisë, të mbajtur me 18 prill 2011, Qeveria aprovoi Vizionin e Zhvillimit Ekonomik të Kosovës për periudhën 2011-2014. Hartimi i prioritetëve të zhvillimit ekonomik të Kosovës bazohet kryesisht në zhvillimin e sektorit privat, fuqizimin e sundimit të ligjit, zhvillimin e kapitalit njerëzor dhe përmirësimin e mirëqenjes sociale.

Plani i zhvillimit ekonomik të Kosovës parashihet një rritje ekonomike prej 7-8%; ulje të papunësisë nga 8-10%; reduktimin e barrierave për bërje të biznesit (50% të procedurave deri më 2014); zhvillimin e politikave të favorshme fiskale, uljen e ekonomisë joformale, etj. Për herë të parë në Kosovë i është dhënë prioritet zhvillimit të sektorit të bujqësisë, e cila paraqitet si një mekanizëm për uljen e papunësisë. Objektivat në këtë sektor janë ngritja e prodhimit, rritja e eksporteve dhe reduktimi i importeve. Në këtë sektor pritet rritja e buxhetit prej 3% në vitin 2012 nga 1% sa është tani, e deri në 5% në vitin 2014.

Pasi që prioritetet e përcaktuara përmes këtij plani devijojnë nga plani qeveritar, është kërkuar të bëhet rishikimi i shpenzimeve publike për identifikimin e kursimeve si dhe përshtatja e shpenzimeve me prioritetet aktuale, e

njëherazi edhe formulimi i prioritetëve buxhetore. Një ndër sfidat kryesore për realizimin e këtij plani është mungesa e buxhetit për përmbushjen e objektivave të lartëpërmendura. Hartuesit e planit parashohin të gjejnë financimin e duhur përmes bilancit bankar, mbështetjes së jashtme, privatizimit dhe borxheve eventuale. Për shkak të përkeqësimit të marrëdhënieve me FMN, që ka ardhur si rezultat i mos-përmbushjes së përgjegjësisë nga Qeveria e Republikës së Kosovës, hartuesit e planit për zhvillim ekonomik i kanë paraparë vështirësitë që mund t'i hasin në mbështetjen e jashtme financiare apo aprovimin e borxheve nga institucionet përkatëse, andaj prioriteti i është dhënë privatizimit, si mënyra më e sigurtë për rritjen e buxhetit, respektivisht krijimin e fondeve të mjaftueshme për përmbushjen e këtyre objektivave. Andaj, si vendime me prioritet të lartë Qeveria konsideron privatizimin e PTK-së deri në dhjetor 2011; privatizimi i distribucionit dhe furnizimit, përmbyllja financiare të përfundojë deri në dhjetor 2011; ndërtimi i termocentralit Kosova e Re, bartja e aseteve të ndodh në dhjetor 2012; privatizimi i Brezovicës; transformimi i mundshëm i sektorit të minierave, etj. Ndërsa në një të ardhme më të largët pritet të ndodh edhe linja e transmisionit me Shqipërinë (2014), aplikimi i

energjisë alternative (2015), ndërsa deri në fund të vitit 2017 edhe rehabilitimi i Kosovës B dhe mbyllja e Kosovës A.

Ndërtimi i autostradës pritet të vazhdojë, e njëherazi të rifillojnë punimet edhe në ndërtimin e autostradës Shkup – Prishtinë – Mitrovicë, si dhe vazhdimi i punimeve në rrugët në drejtim të Pejës dhe Mitrovicës. Për më tepër, si prioritet Qeveria konsideron edhe ndërtimin e linjës hekurudhore që lidhë Kosovën me Serbinë dhe Maqedoninë.

Plani i veprimit pritet të procedohet në Qeveri deri më 15 maj 2011. Plani i prezentuar në këtë mbledhje është më tepër përshkruar, në të cilin nuk theksohen mënyrat si do të arrihen këto objektiva dhe sa realisht janë të zbatueshme. Duhet theksuar se hartimi i këtij plani u mundësua në bashkëpunim me Ambasadën Amerikane në Kosovë, USAID-i, Komisioni Evropian, Banka Botërore dhe DFID-i, të cilët financuan një qëndrim 4 ditor në Banskò të Bullgarisë për gjysmën e qeverisë së Kosovës me qëllim të përpilimit të planit për zhvillim strategjik. Se sa efektive ishin këto 4 ditë qëndrimi në Bullgari, do të shihet në fund të vitit 2011 dhe atij 2012, kohë të cilat janë përcaktuar nga vetë hartuesit e planit për paraqitjen e rezultateve në praktik.



Qeveria ndërron trasenë e autostradës, në kundërshtim me Ligjin për Planifikim Hapësinor

• Zonat e interesit të veçantë ekonomik mund të shpallen vetëm me vendim të Kuvendit të Kosovës. Mosmiratimi e vendimit të Kuvendit për trasenë e autostradës, vështirëson procesin e shpronësimit të pronave kah do të kaloj traseja e re e autostradës.

Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e saj të 11 mbajtur më 27 prillit 2011, mori vendim të ndryshohet traseja e autostradës Vërmicë-Merdare. Ky vendim i Qeverisë së Kosovës bie ndesh me vendimin e Qeverisë nr.13/10 të datës 7 mars 2008 me të cilin i rekomandohej Kuvendit që të aprovoj trasenë e autostradës Vërmicë-Merdare si zonë të interesit të veçantë ekonomik. Këtë rekomandim të Qeverisë, Kuvendi e aprovoi në seancën plenare të 2 qershorit 2008. Sipas trasesë së miratuar në Qeveri dhe Kuvend më 2008 parashihej që traseja e autostradës të kaloj nga Shtimja. Gjatësia e përgjithshme e trasesë ishte 117 kilometra, do të ndërtoheshin 105 ura dhe tre tunele me gjatësi totale 5 kilometra. Sipërfaqja e nevojshme për ndërtim ishte: $S = 1062.2786$ ha, prej të cilave ishte $S = 376.2420$ ha ose 35.42% është pronë shoqërore dhe $S = 686.0366$ ha ose 64% e saj është pronë private.

Tani, me vendimin e djeshëm të Qeverisë, autostrada do të kaloj nga Malisheva, duke anashkaluar tunelin në Qafë të Dulës. Sipas arsytimit të Kryeministrit dhënë në mbledhje të Qeverisë, ndryshimi i trasesë do të kursej 350 milion euro dhe koha e kalimit nëpër autostradë do të zgjatet për vetëm 7 minuta. Traseja e re zgjat rrugën për 15 km. Për ti kaluar 15 km

për 7 minuta nevojitet që ngasësit ti japin automjeteve të tyre 128 km në orë. Shpejtësi e cila është e dënueshme me ligjet aktuale në fuqi.

Mirëpo nuk është dhënë arsytim se në bazë të çfarë studimesh është bërë ky kalkulim. Në seancën e Kuvendit të Kosovës së 2 qershorit 2008, gjatë prezantimit në Kuvend ish ministri i Ministrisë së Transportit dhe Post-Telekomunikacionit z.Fatmir Limaj kishte thënë se çmimi i autostradës e cila do të kaloj nëpër trasenë e miratuar në Kuvend do të jetë rreth 659 milion euro. Në raste se me trasenë e re kursehen 350 milion euro, i bie se çmimi i ndërtimit të autostradës do të jetë 309 milion euro. Kjo shumë është shuma që buxheti i Kosovës ka ndarë vetëm me Buxhetin e Kosovës të 2010 dhe sipas kësaj nuk do të duhej të ndaheshin mjete shtesë për financimin e autostradës më 2011 dhe vitet në vazhdim.

Në vendimin e Qeverisë marr në mbledhjen e 11 të datës 27 prill 2011 nuk i kërkohet Kuvendit që të miratoj trasenë e re. Sipas ligjeve në fuqi, zonat e interesit të veçantë mund të shpallen vetëm me vendim të Kuvendit të Kosovës, pas propozimit nga Qeveria. Sipas Ligjit për Planifikim Hapësinor, neni 12.6, thuhet se pas hartimit të planeve hapësinore për zonat e interesit të

veçantë, ministria ia dërgon ato Qeverisë për miratim paraprak dhe Qeveria ia procedon Kuvendit për aprovim përfundimtar. Përderisa Kuvendi i Kosovës nuk vendos ndryshe, mbetet në fuqi vendimi i Kuvendit i datës 2 qershor 2008 për trasenë e autostradës dhe nuk mund të ndryshohet me vendim ekzekutiv të Qeverisë.

Me rastin e prezantimit të propozimit për trasenë e autostradës më 2 qershor 2008, ministri Limaj kishte deklaruar se “është përfunduar projekti zbatues, studimi i fizibilitetit dhe vlerësimi i ndikimit në mjedis, është realizuar evidencimi i pronave si dhe është bërë paramasa dhe parallogaritja specifike dhe teknike.” Nuk është bërë e qartë nëse këto studime janë bërë edhe për trasenë e re të autostradës.

Mos miratimi i trasesë së re në Kuvend, mund të vështirësoj edhe shpronësimin e pronave në trasenë kah do të kaloj autostrada. Për shkak se deri më tani ka ekzistuar një vendim i Kuvendit për trasenë e autostradës, Qeveria e Kosovës ka pasur të drejtë ligjore që me vendime ekzekutive të shpronësoj pronat në Komunën e Prizrenit dhe Suharekës. Një e drejtë e tillë nuk ekziston edhe për shpronësimin e pronave në trasenë e re, pa marrë pëlqimin e Kuvendit.

Miratohet Korniza Afatmesme e Shpenzimeve 2012-2014

• *Që nga 2007 e deri më tani, asnjë nga KASH nuk është respektuar. Madje KASH është bërë i pa zbatueshëm ende pa hyrë në vitin e parë të funksionimit të tij. Rasti më i rëndë është ai i KASH 2011-2013.*

Në mbledhjen e 13-të të Qeverisë së Kosovës, të mbajtur më 29 prill 2011, u miratua Korniza Afatmesme e Shpenzimeve 2012-2014.

Ky dokument përmban strategjinë fiskale të Qeverisë për periudhën e ardhshme tre vjeçare. Duhet cekur që Korniza Afatmesme e Shpenzimeve që nga viti 2007, shërben si dokument kryesor i planifikimit të politikave qeveritare dhe si e tillë paraqet komponentë të rëndësishme të procesit të përgjithshëm buxhetor. Mirëpo, që nga 2007 e deri më tani, asnjë nga KASH nuk është respektuar. Madje KASH është bërë i pa zbatueshëm ende pa hyrë në vitin e parë të funksionimit të tij. Rasti më i rëndë është ai i KASH 2011-2013.

KASH 2012-2014 ka për qëllim të:

- Promovojë disiplinën fiskale dhe të prezantojë vlerësime reale mbi nivelin e të hyrave buxhetore;
- Të prezantojë politikat fiskale në funksion të implementimit të politikave prioritarë të Qeverisë.;
- Të sigurojë një ambient të qëndrueshëm makroekonomik, në funksion të zhvillimit të sektorit privat;
- Të përcaktojë kufijtë e shpenzimeve me qëllim që të sigurojë

nivel të ulët të deficitit fiskal.

Edhe një herë, Qeveria paraqet 4 shtyllat apo prioritetet përgjatë mandatit të saj qeverisës:

- Përkrahja dhe krijimi i parakushteve për rritje dhe zhvillim të qëndrueshëm ekonomik;
- Qeverisje të mirë dhe fuqizim të sundimit të ligjit;
- Zhvillim të kapitalit njerëzor;
- Rritje e mirëqenies sociale për të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës.

Ky dokument paraqet sfidat me të cilat ballafaqohet ekonomia kosovare siç janë: niveli shumë i ulët i eksportit në raport me importin, ulja e ndjeshme nga vitet paraprake të investimeve të huaja direkte, ekonomia informale, niveli i lartë i papunësisë, mungesa e hartimit të politikave konkrete që do të bënin të mundur adresimin e këtyre problemeve dhe zgjidhjen e tyre etj.

Gjithashtu, në këtë dokument janë paraqitur politikat prioritarë të qeverisë të cilat janë: investimet e mëtutjeshme në fushën e transportit, përmirësimi i furnizimit me energji elektrike që duhet të bëhet përmes kryerjes së reformave të nevojshme, privatizimi i distribucionit të KEK-ut si dhe ndërtimi i

burimeve të reja të energjetikës, zhvillimin e sektorit të arsimit për t'iu mundësuar të rinjve të marrin aftësitë e nevojshme profesionale për të bërë të mundur inkudrimin e tyre në treg, ngritjen e funksionalitetit të sistemit të gjyqësorit që konsiderohet si katalizator i krijimit të një klime të favorshme për investime dhe rritje ekonomike, reformat fiskale, luftimi i ekonomisë informale përmes projektit të filluar rishtazi nga Qeveria për fiskalizimin e bizneseve, reformimi i administratës publike, sigurimi i mëtutjeshëm i asistencës financiare nga ana e donatorëve si dhe luftimi i korrupsionit.

Sidoqoftë, për shkak të fillimit të implementimit të projektit të ndërtimit të autostradës Vërmicë-Merdarë, shumë nga këto prioritetet të Qeverisë pritet të kenë efekte anësore financiare në zbatimin e përgjithshëm të tyre.

Ndryshe, në kontekst të projeksioneve makroekonomike, përgatitja është bërë në dy skenare; skenari i parë është bërë mbi bazën e projeksioneve të prezentuara në buxhetin e Kosovës për vitin 2011, dhe skenari i dytë gjatë përgatitjes së projeksioneve në KASH 2012-2014, është bërë mbi bazën e Vizionit të Zhvillimit Ekonomik të

miratuar nga Qeveria në prill të këtij viti.

Nëse e marrim në konsideratë skenarin e parë të projeksioneve makroekonomike, atëherë për periudhën 2012-2014, rritja ekonomike do të jetë 5.5% e BPV, ndërkaq, skenari i dytë do të rezultojë me një shifër prej afër 7.2% të BPV-së. Në vitin 2011, BPB do të jetë 5.3%, ndërsa në vitin 2012 do të ngritët në 6.6%, 7.8% do të jetë në vitin pasues dhe në vitin e fundit, pra në vitin 2014, BPB pritet të jetë rreth 7.4% (shifrat që burojnë nga skenari i dytë).

Nga treguesit tjerë makroekonomik, konsumi pritet të shënojë një mesatare vjetore prej 4.7% duke arritur kështu mesatarisht pjesëmarrjen në BVP në 106.6% gjatë periudhës 2012-2014; krahasuar me 109.3% siç parashikohet për vitin 2011. Gjithashtu, investimet pritet të shënojnë rritje prej €1.6 miliardë në vitin 2011 në €1.8 miliardë në vitin 2014. Eksportet po ashtu pritet të shënojnë rritje ku nga €995 milionë sa pritet të jetë në vitin 2011, do të arrijnë në

€1,049 në vitin 2014. Ndërkaq, edhe importet pritet të kenë rritje nga €2.7 miliardë në vitin 2012, në €3.1 miliardë në vitin 2014.

Sa i përket inflacionit, gjatë periudhës së projektuar kjo shifër do të sillet në rreth 1.6% që konsiderohet stabil nga ekspertët e ekonomisë. Të hyrat e përgjithshme buxhetore deri në fund të vitit 2014, pritet të arrijnë shumën prej €1,444 milion, ose të jenë rreth 27% më të larta se sa në vitin 2010. Shpenzimet e përgjithshme gjatë periudhës së projektuar 2012-2013, pritet të shënojnë ngritje të vazhdueshme dhe duke arritur vlerën prej € 1,487 milion gjatë vitit 2013, apo një rritje prej rreth 4% krahasuar me vitin 2011. Ndërsa që parashikimet sugjerojnë që gjatë vitit 2014 shpenzimet e përgjithshme buxhetore pritet të shënojnë një rënie të lehtë krahasuar me vitin 2013, për tu rikthyer serish në nivel të ngjashëm të shpenzimeve të projektuara gjatë vitit 2011. Kjo rënie pritet të ndodhë si rezultat i finalizimit të projektit të madh kapital, dhe si

pasoje uljes së kategorisë së shpenzimeve kapitale gjatë atij viti krahasuar me vitin 2013. Një situatë e tillë do të ndikojë në uljen e theksuar të deficitit të përgjithshëm të projektuar buxhetor gjatë atij viti, i cili pritet të ulet nga €127 milion euro gjatë vitit 2013 në €32 milion gjatë vitit 2014. Pra me rritjen e shpenzimeve në raport me të hyrat, Kosova pritet të realizojë deficit buxhetor nga viti 2011 deri në vitin 2014. Deficiti buxhetor për vitin 2011 pritet të jetë rreth €227 milionë, pastaj në vitin 2012 deficiti pritet të rritet në €159 milionë, pastaj në vitin 2013 pritet të shënojë ulje në €127 milionë dhe në vitin 2014 pritet të jetë €32 milionë.

Ligji mbi Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, gjegjësisht neni 19, që flet për përgatitjen e Kornizës Afatmesme të Shpenzimeve, e obligon Qeverinë që deri më 30 prill të secilit vit kalendarik t'ia dorëzojë Kuvendit këtë dokument për vitin e ardhshëm fiskal si dhe vlerësimet për dy vitet e ardhshme fiskale.



Miratohet Raporti Tremujor i Buxhetit për Vitin 2011

- *Meqë pranimet gjatë tremujorit të parë të vitit 2011 janë më të mëdha se pagesat, kemi një suficit buxhetor prej 67.86 milion euro, të cilit i duhen hequr pagat e muajit mars..*
- *Pagat me rritje janë dhënë për muajin mars, dhe jo për muajt janar dhe shkurt. Nuk dihet se në cilën periudhë raportuese do të përfshihen edhe shtesat që punëtorët në sektorin publik nuk i kanë marur për dy muajt e parë të 2011.*

Në mbledhjen e 12-të të Qeverisë së Kosovës, të mbajtur më 27 Prill 2011, është miratuar Raporti Tremujor i Buxhetit për vitin 2011, sipas nenit 45 të Ligjit mbi Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, i cili kërkon që Ministri i Financave të prezantoj raportin tremujor të buxhetit në fund të çdo tremujori. Ndarja buxhetore në këtë raportim është bërë sipas Ligjit Nr. 04/L-001 dhe sipas SIMFK-B (sistemit financiar të përpiluar posaçërisht për Qeverinë e Kosovës). Ndarja buxhetore për tremujorin e parë të vitit 2011 dallon për 126 milion euro, siç mund të shihet në tabelën më poshtë:

Gjatë tremujorit të parë, pranimet kanë qenë në shumë prej 243.91 milion euro, 19.3% të planit vjetor, apo 22.1% më të larta se në periudhën e njëjtë të vitit 2010. Të hyrat më të larta janë gjeneruar nga tatimet kufitare që përbëjnë 61% të pranimeve totale dhe janë 23% më të larta se në tremujorin e parë të vitit 2010.

Pagesat totale gjatë kësaj periudhe kanë qenë 175.28 milion euro, apo 13% të ndarjeve vjetore dhe janë 30% më të ulëta se pagesat e periudhës së njëjtë të vitit paraprak. Mirëpo,

Pagat me rritje janë dhënë për muajin mars, dhe jo për muajt janar dhe shkurt. Nuk dihet se në cilën periudhë raportuese do të përfshihen edhe shtesat që punëtorët në sektorin publik nuk i kanë marur për dy muajt e parë të 2011.

duhet theksuar se pagat e muajit mars nuk janë të përfshira në këto pagesa, pasi që ato janë paguar në muajin prill për shkak të vonesës në miratimin e Ligjit për Buxhetin. Nëse pagat e muajit mars do të përfshiheshin në këtë tremujor, atëherë kemi një rritje prej 3.796 milion euro rritje në pagesën e pagave në krahasim me periudhën e njëjtë të vitit 2010, dhe atë pa rritjen e pagave të miratuar nga qeveria. Pagesat për investime kapitale gjatë kësaj periudhe janë 188% më të larta se në periudhën e njëjtë të vitit 2010, prej të cilave rritje më të madhe ka shënuar investimi në ndërtimin e rrugëve që është 443% më i lartë se në tremujorin e parë 2010.

Prandaj, meqë pranimet gjatë tremujorit të parë të vitit 2011 janë më të mëdha se pagesat, kemi një suficit buxhetor prej 67.86 milion, të cilit i duhen hequr pagat e muajit mars.

	Ligjit Nr. 04/L- 001	SIMFK
Buxheti për Qeverinë Qendrore 2011	1,063	963
Granti i përgjithshëm i Qeverisë për Komunat 2011	300	274
Të hyrat vetanake komunale 2011		
Të hyrat vetanake komunale të bartura nga viti 2010	0	0
Të hyrat vetanake qendrore të mbledhura në vitin 2011	0	3
Të hyrat vetanake qendrore të bartura nga viti 2010	0	1
Financimet tjera	56	56
Gjithsej ndarjet buxhetore të vitit 2011	1,471	1,345

Miratohet Rregullorja për Koordinimin e Donatorëve

• Miratimi i këtij dokumenti ka qenë jashtëzakonisht i nevojshëm duke marrë parasysh faktin që një pjesë e madhe e donacioneve nuk po destinohen sipas planeve dhe parashikimeve, vërejtje këto të bëra shpesh herë nga vet donatorët.

Në mbledhjen e 11-të të Qeverisë së Kosovës, të mbajtur më 20 prill 2011, u miratua Rregullorja për Koordinimin e Donatorëve.

Qëllimi i kësaj rregulloreje është të ngritë rolin e Republikës së Kosovës në koordinimin e ndihmës së jashtme, krijimin e një sistemi që siguron efektivitetin dhe transparencën në mes të aktiviteteve të Qeverisë së Kosovës dhe bashkësisë së donatorëve.

Po ashtu, me këtë rregullore, me qëllim të koordinimit, shqyrtimit dhe mbikëqyrjes së procesit të ndihmës për projektet në zhvillim të ndërlidhura me strategjitë sektoriale themelohen këto organe: Forumi i Nivelit të Lartë (FNL); Grupet Punuese Sektoriale (GPS); dhe, Grupet Punuese Nën-sektoriale (GPNS).

Forum i Nivelit të Lartë vendosë

prioritetet kryesore për strategjitë e ndihmave për zhvillimin e sektorëve. Ky forum, poashtu bën miratimin e prioriteteve vjetore dhe shumëvjeçare për ndihmën e donatorëve në të gjithë sektorët të cilat duhet të jenë në përputhshmëri të plotë me dokumentet strategjike kryesore të Qeverisë si KASH-i, PVPE, Plani Vjetor i Qeverisë etj. Ky forum kryesohet nga Kryeministri. Anëtarë të këtij forumi janë: ministri, institucionet e pavarura, ambasadorët ose shefat e agjencive që përfaqësojnë organizatat donator bilateral dhe multilateral.

Grupet Punuese Sektoriale janë grupe për koordinim të ndihmës së donatorëve të udhëhequra nga Qeveria që merren me strategji sektoriale dhe vendime operative rreth prioriteteve për ndihmë të një sektori të veçantë. Ministria që përfaqëson sektorin udhëheq GPS përkatëse e përkrahur nga Ministria e

Integritimit Evropian (MIE).

Ndërkaq, të njëjtin funksion e luajnë edhe Grupet Punuese Nën-sektoriale, mirëpo me nënsektorët specifik. GPND i raportojnë GPS-ve përkatëse. Ministritë janë përgjegjëse për zgjedhjen e strukturës dhe funksionimin e tyre.

Miratimi i këtij dokumenti ka qenë jashtëzakonisht i nevojshëm duke marrë parasysh faktin që një pjesë e madhe e donacioneve nuk po destinohen sipas planeve dhe parashikimeve, vërejtje këto të bëra shpesh herë nga vet donatorët. Koordinimi i ndihmave, në secilin vend, jo vetëm në Kosovë, është një detyrë e vështirë dhe gjithnjë duhet të shoqërohet me përgjegjësi dhe transparencë. Mungesa e përgjegjësisë dhe transparencës ndikon drejtpërdrejtë në ndërprerjen e dhënies së donacioneve për çka vendi ynë ka ende shumë nevojë.



Qeveria i propozoi Kuvendit ish kryeprokurorin z. Osman Kryeziu për anëtarë në Organin Shqyrtues të Prokurimit

Në mbledhjen e 12-të, të mbajtur më 27 prill 2011, me vendimin 13/12, Qeveria i propozoi Kuvendit ish kryeprokurorin Z. Osman Kryeziu për anëtar në Organin Shqyrtues të Prokurimit.

Organi Shqyrtues i Prokurimit (OShP) është organ i pavarur administrativ i Administratës Publike të Republikës së Kosovës. Ky organ është përgjegjës për kryerjen e funksioneve që i janë caktuar sipas Ligjit për Prokurim Publik në Kosovë si dhe Ligjit për Proce-

durën për dhënien e koncesioneve (Ligji Nr.02/L-44) lidhur me trajtimin e ankesave në relacion me këto ligje.

OSHP-ja, ka strukturën si në vijim: Kryetari i OShP-së, dhe organi i OShP-së 5 anëtarësh. Sipas nenit 2 të Rregullores së Punës të Organit Shqyrtues të Prokurimit, Kuvendi i Republikës së Kosovës sipas Ligjit, pas kërkesës me shkrim nga Kryetari i OShP-së, mund të emëroj një ose më shumë persona shtesë si

anëtarë të përkohshëm të paneleve shqyrtuese dhe atë vetëm atëherë kur kemi të bëjmë me rritje të vëllimit të punëve-shtimit të numrit të lëndëve në OShP.

Ndërsa, anëtari i organit të OShP-së, merr përgjegjësinë për të qenë prezent në Panelet Shqyrtuese, dhe në ndonjë punë tjetër që i caktohet atij nga Kryetari i OShP-së si dhe mund të përfaqësojë OShP-në në rastet e caktuara të aktiviteteve nëse ai/ajo është caktuar të bëjë këtë nga Kryetari i OShP-së.

Organi kompetent që lëshon pasaportën
Надлежни орган који издаје пасош
Passport-issuing authority

Signature



Nënshkrimi i personit zyrtar / Подпис службеног лица / Signature

Dokumentet personale mund të merren edhe në konsullatat e Kosovës

• *Aprovohet kërkesa e MPJ-së për angazhimin e zyrtarëve për pajisje me dokumente personale nëpër misionet konsullore të Republikës së Kosovës.*

Me vendimin 12/12, të datës 27 prill 2011, Qeveria miratoi kërkesën e MPJ-së për caktimin e zyrtarëve të Ministrisë së Punëve të Brendshme në Misionet Konsullore të Republikës së Kosovës, duke angazhuar zyrtarë për pajisjen me dokumente personale nëpër misionet konsullore të Republikës së Kosovës.

Kohëzgjatja, detyrat dhe përgjegjësitë, caktimi i pagës, si dhe çështjet financiare dhe buxhetore të personelit të caktuar nga Ministria e Punëve të Brendshme me detyra zyrtare në Misionet Konsullore rregullohen me marrëveshje ndërmjet Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Ministrisë së Punëve të Brendshme.

Duke u bazuar në nenin 10.1, të Ligjit për Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Shërbimin Diploma-

tik të Republikës së Kosovës, personeli nga ministrinë, agjencitë ose organet e tjera të shtetit mund të caktohen në detyra zyrtare në ambasada dhe misione të tjera të Kosovës me pëlqimin e Ministrisë së Punëve të Jashtme të Kosovës. Përderisa, detyrat dhe përgjegjësitë financiare të person-

elit të caktuar me detyra zyrtare në misionet jashtë vendit, rregullohen me Marrëveshje të Shkallës së Shërbimit

ndërmjet Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe organit që cakton zyrtarin.

Ndërsa, personeli i caktuar me detyrë zyrtare në mision konsiderohet i barabartë me anëtarët e tjerë të misionit të të njëjtit rang dhe vihet nën autoritetin e shefit

te misionit në lidhje me përmeshjen e detyrave dhe sjelljen e tyre të përgjithshme.

Që nga data 15 qershor 2010, të gjitha përfaqësitë diplomatike/konsullore të Republikës së Kosovës të akredituara jashtë ofrojnë shërbime konsullore. Të gjithë klientët konsullorë që jetojnë në rrethin përkatës të juridiksionit të Misioneve Diplomatike/Konsullore të Republikës së Kosovës mund të paraqesin kërkesa për këto shërbime konsullore: pajisje me fletë-udhëtim për kthim; aplikim për pasaportë të Republikës së Kosovës (për kategorinë e shtetasve që janë pajisur me Letërnjoftim të Kosovës); aplikim për regjistrimin e fakteve të gjendjes civile (lindje, martesë, vdekje); aplikim për fitimin e shtetësisë së Kosovës; aplikim për heqje dorë nga shtetësia e Kosovës me lirim; vërtetimeve të çdo lloji; shërbime të tjera në raste emergjente.

Deri më tani, shumë pak qytetarë kanë arrit të pajisen me dokumente personale në konsullatat e Kosovës

Themelohet Këshilli Konsultativ për Drejtësi dhe Institutit për Hulumtimin e Krimeve të Luftës në Kosovë prej vitit 1990-1999

• *Ky këshill ka për qëllim avancimin e sistemit të drejtësisë dhe sundimit të ligjit në zbatimin e strategjisë dhe organeve tjera gjyqësore dhe prokuroriale.*

Në mbledhjen e 13-të, të mbajtur më 29 Prill 2011, Qeveria e Kosovës ka miratuar propozimin e Ministrit të Drejtësisë për themelimin e Këshillit Konsultativ për Drejtësi. Ky këshill ka për qëllim avancimin e sistemit të drejtësisë dhe sundimit të ligjit në zbatimin e strategjisë dhe organeve tjera gjyqësore dhe prokuroriale. Gjithashtu, përmes këtij Këshilli do të sigurohen kushte për marrjen e masave konkrete në reformimin e gjyqësorit të shërbimit korrektues dhe çështje tjera në fushën e drejtësisë në Republikën e Kosovës.

Në bazë të këtij propozimi do të obligohet Ministria e Drejtësisë, Këshilli i Prokurimit, Këshilli Gjyqësor dhe të tjerët që të propozojnë aktet ligjore në fushën juridike dhe t'i dërgojnë ato në këshill për marrje të vendimit. Ky këshill do të ketë 15 anëtarë, secili prej tyre i emëruar nga një bazë e veçantë, duke përfshirë atë nga

Qeveria, Kuvendi i Kosovës, Përfaqësuesi Civil, EULEX-i, OSBE-ja, Organet Gjyqësore dhe Prokuroriale, nga Universiteti dhe Shoqëria Civile. Këshilli do të ketë edhe kryetarin, të zgjedhur nga anëtarët e këshillit me shumicën e thjeshtë të votave, por me propozimin fillestar nga shoqëria civile. Këshilli punon dhe merr vendime me shumicën e thjeshtë të votave, të cilat do të jenë publike, dhe me këshillimin e ekspertëve vendorë dhe të huaj. Vendimi i propozuar parashihet të fillojë të aplikohet nga 1 Qershori i vitit 2011. Ndërkaq kostoja që do t'i ngarkohet buxhetit të Kosovës për themelimin e këtij këshilli nuk është paraqitur në mbledhjen e Qeverisë kur është miratuar ky vendim.

Gjithashtu, në mbledhjen e 13-të të Qeverisë u miratua edhe themelimi i Institutit për Hulumtimin e Krimeve të Luftës në Kosovë prej vitit 1990 deri 1999

në kuadër të Ministrisë së Drejtësisë. Ky Institut do të jetë një institut publik hulumtues me qëllim të koordinimit, përcjelljes dhe hulumtimit të krimeve të luftës, krimeve kundër paqes, gjenocidit dhe shkeljeve tjera të rënda të të drejtave të njeriut.

Disa nga detyrat kryesore të këtij Instituti do të jenë: grumbullimi, përpunimi, klasifikimi dhe arkivimi i lëndëve për krimet e luftës, krimet kundër njerëzimit etj. Gjithashtu, instituti do të analizojë këto krime, të bëjë verifikimin e tyre për ndjekje penale të mundshme dhe rezultatet e arritura do të bëhen publike.

Sigurimin e mjeteve financiare për themelimin e këtij Instituti do ta bëjë Ministria e Drejtësisë (shuma e paraparë nuk është bërë e ditur) në mënyrë që kur Kosova mendon të ngrejë padi për krime lufte, të kemi një përgatitje të bazuar në hulumtime shkencore.



Miratohet vendimi për aplikimin e normës së Tatimit të Akcizës për Lojëra të Fatit

• *Edhe një vendim i cili kontribuon mbledhjes së të hyrave për Buxhetin e Kosovës.*

Në mbledhjen e 13-të të Qeverisë së Kosovës, të mbajtur më 29 Prill 2011, u miratua propozimi i Ministrisë së Financave për aplikimin e normës së Tatimit të Akcizës për Lojëra të Fatit.

Ministria e Financave, për të ardhur deri tek ky vendim, ishte konsultuar me komisionin për Buxhet dhe Financa, duke u bazuar në nenin 3, paragrafi 2 të Ligjit për Normën e Tatimit të Akcizës, Ligji nr. 03/L – 220. Komisioni për Buxhet dhe Financa, Oda Ekonomike e Kosovës, Oda Eko-

nomike Amerikane dhe Agjencia Kosovare e Bizneseve kanë dhënë mbështetje të plotë për vendosjen e kësaj norme të tatimit. Më parë, lojërat e fatit kanë qenë të tatuara me TVSH, ndërkaj me harmonizimin e ligjit të TVSH-së me direktivat e Këshillit Evropian 2006/112/EC mbi sistemin e për-bashkët të TVSH-së, lojërat e fatit janë liruar nga tatimi mbi vlerën e shtuar që nga Korriku i vitit 2010.

Normat e tatimit të akcizës që janë aprovuar për lojërat e fatit janë si në vijim:

- Kasinot – 5000 euro për çdo muaj, plus lojërat elektronike me slot makina, kompjuter apo makina elektronike 500 euro për muaj për secilën makinë.
- Bastet sportive – 600 euro në muaj për çdo pikë të shitjes
- Operatorët e lojërave në automate – 500 euro në muaj
- Ruletë për makina elektronike – 300 euro në muaj
- Tumbollat bingo në lokale të mbyllura – 100 euro në muaj
- Lotaria e Kosovës – 16% të vlerës së tiketave të shitura për çdo muaj

Aprovohet Projekti për Studimin e fizibilitetit dhe Fillimin e Procedurave për Analizimin e Opsioneve Kontraktuese për Operim dhe Mirëmbajtje të Autostradës Morinë-Merdare

• *Ministria e Infrastrukturës ende nuk ka paraqitur asnjë plan konkret se si synon t'i arrijë këto qëllime.*


Në mbledhjen e 13-të, të mbajtur më 29 Prill 2011, Qeveria e Kosovës i ka dhënë dritën e gjelbër projektit të Ministrisë së Infrastrukturës për studimin e opsioneve kontraktuese për operim dhe mirëmbajtje të autostradës Morinë-Merdarë. Zhvillimi i këtyre projekteve rrugore ka rëndësi primare për ekonominë e Kosovës duke përfshirë lidhjen kryesore në kuadër të rrjetit rajonal të transportit me kryeqytetet fqinje dhe me qytetet kryesore. Gjithashtu, përgatitja e studimit të arsyeshmërisë së sistemit të operimit dhe mirëmbajtjes së autostradës Morinë-Merdarë është me rëndësi pasi që siguron ruajtjen e vlerës së investimeve, tërheqjen e kapitalit

privat si një nga mundësitë reale për zhvillimin ekonomik, ruajtjen e cilësisë së autostradës si dhe zvogëlimin e kostonë së mirëmbajtjes.

Ky vendim u aprovua në mbledhjen e Qeverisë, megjithëse Ministria e Infrastrukturës ende nuk ka paraqitur asnjë plan konkret se si synon t'i arrijë këto qëllime. Gjithashtu, ende nuk është vendosur nëse do të aplikohen pagesa për autostradë dhe se a do të ketë taksë për hapje të bizneseve përgjatë autostradës.

Në këtë mbledhje, Qeveria ka mbështetur edhe fillimin e procesit të koncesionimit apo zhvil-

limit të partneritetit publiko-privat për rrugën Prishtinë-Hani i Elezit, të propozuar nga Ministria e Infrastrukturës. Ky propozim-vendim përmban përgatitjen e studimit të arsyeshmërisë dhe opsioneve kontraktuese që do të mundësojnë realizimin e projektit sipas skemës së partneritetit publiko-privat. Ministria e Infrastrukturës me resurset e veta profesionale do të bashkëpunoj me akter të lirë, siç është Njësia Qendrore e Partneritetit Publiko-Privat në kuadër të Ministrisë së Financave në mënyrë që ky proces të jetë i shpejtë, i leverdishëm dhe transparent. Ndërkaq opsionet e mundshme kontraktuese do të paraqiten më vonë.



Iu vazhdohet pagesa ish pjesëtarëve të TMK-së dhe iu rriten pagat Institutit Albanologjik dhe atij të Historisë

• *Kjo është hera e dytë që qeveria ndërmerr një hap të tillë, pas shpërbërjes së strukturës së TMK-së dhe transferimit të saj në FSK.*

Në mbledhjen e 12-të të Qeverisë së Kosovës, e cila u mbajt më 27 prill 2011, u morr vendimi që t'iu vazhdohet pagesa 797 ish pjesëtarëve të TMK-së, prej muajit janar deri në qershor 2011, në shumën prej 50% të pagës bazë të cilën e kanë gëzuar deri më 31 maj 2010. Gjithashtu, në vendim thuhet që pagesa do t'i ndërpritet çdo pjesëtar i TMK-së në rast të punësimit eventual.

Kjo është hera e dytë që qeveria ndërmerr një hap të tillë, pas shpërbërjes së strukturës së TMK-së dhe transferimit të saj në FSK. Vendimi i parë ishte marrë më 2 korrik të vitit të kaluar ku 836 pjesëtarëve të ish TMK-së iu vazhdua kompensimi pas përfundimit të programit të udhëhequr nga UNDP e cila kishte të bënte me

sistemimin e pjesëtarëve të TMK-së të cilët nuk arritën të jenë pjesë të FSK-së. Ky program përfundoi më 1 qershor të 2010.

Si pjesë e pakos së ligjeve të Ahtisarit, ishte edhe ligji për FSK-në i cili ka hyrë në fuqi më 15 qershor 2008. Në këtë ligj thuhet qartë që kjo strukturë e re civile do t'i ketë 2500 pjesëtarë aktiv dhe 800 pjesëtarë rezervë. Misioni i saj ka karakter civil edhe i përgjigjet thirrjeve ndaj situatave emergjente. Po ashtu, specifikohet në ligj, FSK duhet të jetë e armatosur lehtë dhe çdo ndryshim i këtyre kufizimeve ose misionit të saj do të bëhet jo më herët se pesë vite nga koha e hyrjes në fuqi të këtij Ligji dhe do të përcaktohet nga Prania Ushtarake Ndërkombëtare në bashkërendim me Përfaqësue-

sin Civil Ndërkombëtar.

Ndërkaq, në po të njëjtën mbledhje, Qeveria miratoi kërkesën e Ministrisë së Arsimit për rritjen e pagave në Institutin Albanologjik në shumë prej 171.330,39 euro për vit dhe në Institutin e Historisë në vlerë prej 93.809 euro.

Në tabelat e Buxhetit të Kosovës për vitin 2011, të gjitha institutet që veprojnë në Kosovë si kategori e arsimit të lartë, ku janë të përfshira edhe institutet e lartëcekura do të kenë buxhet për paga dhe mëditje gjithsejtë 372.332 euro ku do të paguhen 94 punëtorë për një vit. Nëse ia shtojmë edhe shtesën e paraqitur në këtë vendim atëherë buxheti i përgjithshëm për paga dhe mëditje për këto institute do të jetë 637.471 euro për këtë vit.



Qeveria vazhdon me rimiratimin e projektligjeve të mbetura në procedurë nga mandati i kaluar

• Pas shpërbërjes së Kuvendit, projektligjet është dashur të miratohen përsëri në ekzekutiv dhe më pas të procedohen edhe një herë Kuvend.

• Pas shpërbërjes së Kuvendit, projektligjet është dashur të miratohen përsëri në ekzekutiv dhe më pas të procedohen edhe një herë Kuvend sipas Rregullores së Kuvendit Nr. 86, "në fund të mandatit të këtij institucioni legjislativ, të gjitha punët që i janë besuar atij (Kuvendit) konsiderohen të përfunduara. Kjo nuk gjen zbatim në rastin e ligjeve të miratuara nga Kuvendi e të proceduara për shpallje, si dhe të peticioneve dhe të atyre punëve, që nuk kërkojnë të merret një vendim nga Kuvendi."

Në tri mbledhjet e fundit (10, 11 dhe 12), Qeveria e Republikës së Kosovës vazhdoi me ri-miratim të disa Projektligjeve të cilat pas shpërbërjes së Kuvendit i janë kthyer edhe njëherë Qeverisë për procedim duke u bazuar në Rregulloren e Kuvendit të Republikës së Kosovës, respektivisht në Nenin 86.

Projektligjet të cilat u kthyen në Qeveria për ri - miratim janë:

- Projektligjin e Sigurimit të Detyrueshëm nga Autopërgjegjësia ndaj Palëve të Treta (i cili u miratua me 29 gusht 2010 në mbledhjen e 146-të, gjithashtu i paraparë në Strategjinë Legjislative 2011 për miratim me 1 korrik 2011);

- Projektligji për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit për Verërat (i miratuar me 5 tetor 2010 në mbledhjen e 147-të, gjithashtu i paraparë në Strategjinë Legjislative 2011 për miratim me 31 mars 2011);

- Projektligji për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit për Mbrojtjen dhe Promovimin e të Drejtave të Komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre në Republikën e Kosovës (i miratuar me 22 prill në mbledhjen e 121-të, gjithashtu i paraparë në Strategjinë Legjislative 2011 për miratim me 1 maj 2011);

- Projektligjin për Efçencën e Energjisë Elektrike (i miratuar me 7 prill 2010 në mbledhjen e 119-të, gjithashtu i paraparë në Strategjinë Legjislative 2011 për miratim me 30 prill 2011);

- Projektligji për Kontabilitet, Raportim Financiar dhe Auditim (i miratuar me 1 shtator 2010 në mbledhjen e 143-të, gjithashtu i paraparë në Strategjinë Legjislative 2011 për miratim me 31 mars 2011);

- Projektligjin për Këshillin Ekonomiko Social (i miratuar me 25 gusht në mbledhjen e 141-të, gjithashtu i paraparë në Strategjinë Legjislative 2011 për miratim me 31 mars 2011).

Dokumenti i Politikave për Kontrollin e Brendshëm të Financave Publike dhe Planin e Veprimit

• Ky dokument është përgatitur sipas projektit të BE-së për sigurimin e mbështetjes në përmirësimin e Menaxhimit publik, kontrollit dhe llogaridhënies, një projekt ky i rëndësishëm veçanërisht për shtetet që synojnë anëtarësim në BE, siç është rasti i Kosovës.

Në mbledhjen e saj të 12-të, të mbajtur më 27 Prill 2011, Qeveria e Kosovës ka miratuar Dokumentin e Politikave për Kontrollin e Brendshëm të Financave Publike dhe Planin e Veprimit. Ky dokument është përgatitur sipas projektit të BE-së për sigurimin e mbështetjes në përmirësimin e Menaxhimit publik, kontrollit dhe llogaridhënies, një projekt ky i rëndësishëm veçanërisht për shtetet që synojnë anëtarësim në BE, siç është rasti i Kosovës. Në këtë dokument përshkruhen parimet bazë të KBFP-së, vlerësimi i arritjeve të gjertanishme të Qeverisë, si dhe rekomandimet për veprimet e

nevojshme në të ardhmen, duke përshkruar gjithashtu edhe mënyrën se si Qeveria planifikon të bëjë përmirësimet e nevojshme. Ky dokument ofron edhe një plan përmes të cilit mund të monitorohet progresi i ardhshëm.

Dokumenti i politikave për kontrollin e brendshëm fillimisht ishte publikuar më 25 Janar 2005 dhe azhurnuar më 2 Maj 2007. Gjërat të cilat i janë shtuar dokumentit të vitit 2007 janë: Përcaktimi i standardeve të pritura të praktikës së KBFP-së; Sigurimi i një analize koherente, duke kombinuar parimet, vlerësimet dhe deklaratat e

objektivave; adresimi i vlerës për para ose llogaridhënie menaxheriale; sigurimi i burimeve për objektivat apo standardet të cilat ai i promovon; përfshirja e analizës së boshllëqeve; e lidh qartë deklaratën, objektivat, përgjegjësitë dhe planin e veprimit të politikave.

Miratimi i këtij projekti mundëson kontrollin e brendshëm të objektivave të qeverisë, të ushtruar nga agjencitë qeveritare të centralizuara dhe të decentralizuara, duke theksuar nëse këto aktivitete kanë karakter administrativ, menaxherial apo buxhetor.

Miratohet Projektligji për Mbrojtjen e Dëshmitarëve

- *Ligji për Mbrojtjen e Dëshmitarëve është nja nga ligjet më të rëndësishme e që i ka munguar Kosovës.*
- *Në raportet e ndryshme ndërkombëtare, duke përfshirë edhe Raportet e Progresit të Komisionit Evropian, Kosova është kritikuar për mungesën e këtij ligji.*

Në mbledhjen e 11 të datës 20 prill 2011, Qeveria e Kosovës me vendimin 02/11, miratoi Projektligjin për Mbrojtjen e Dëshmitarëve. Qëllimi i këtij Projektligji është rregullimi i masave të posaçme dhe të përkohshme si dhe të jashtëzakonshme, mënyra dhe procedurat e mbrojtjes së dëshmitarëve si dhe organizimi, funksionimin, kompetencat dhe marrëdhëniet ndërmjet organeve të ngarkuara për propozimin, vlerësimin, miratimin, zgjatjen dhe zbatimin e programit të mbrojtjes së dëshmitarëve.

Bazat për aplikimin e masave mbrojtëse, bazuar në Nenin 3 të projektligjit, zbatohen gjatë dhe pas procedurës penale për personin e rrezikuar në lidhje me hetimet për veprat penale si vijon: veprë penale kundër Kosovës, shtetasve dhe banorëve të saj ashtu siç parashihet në Kapitullin përkatës të Kodit Penal të Republikës së Kosovës; veprë penale kundër të drejtës ndërkombëtare ashtu siç parashihet në Kapitullin përkatës të Kodit Penal; veprë penale e kryer nga një grup i organizuar kriminal; veprë penale për të cilën me ligj parashihet dënimi me pesë apo më shumë vite burgim.

Sipas nenit 4, masat mbrojtëse zbatohen për të siguruar mbro-

jtje të personit të mbrojtur nga rreziku serioz ndaj jetës së tij, shëndetit fizik apo psikik apo ndaj personave të afërm të përcaktuar në këtë Ligj.

Masat mbrojtëse janë si në vijim: mbrojtja fizike e personit të mbrojtur; zhvendosja e përkohshme e personit të mbrojtur në vend të sigurt; procedurat e veçanta për qasje në të dhëna dhe dokumente në lidhje me personat e mbrojtur, nga zyrat e lëshimit të dokumenteve dhe bazës së të dhënave tjera formale; ndërrimi i vendbanimit, punës apo shkollimit të personit të mbrojtur; ndërrimi i identitetit të personit të mbrojtur; ndryshimi i pamjes fizike të personit të mbrojtur duke përfshirë edhe operacionin plastik; mbështetje financiare për personin e mbrojtur; mbështetja sociale, ligjore dhe çfarëdo mbështetje tjetër e nevojshme për personin e mbrojtur. Kjo mbrojtje fizike e personit të mbrojtur bëhet në formë të hapur apo të fshehtë, e zbatuar gjatë 24 orësh apo gjatë periudhave të caktuara kohore dhe vetëm brenda territorit të Republikës së Kosovës.

Po ashtu, më anë të këtij ligji themelohet edhe Komisioni për Mbrojtjen e Dëshmitarëve i cili është përgjegjës për përfshirjen

e personit të rrezikuar në program, për zgjatjen e qëndrimit në program si dhe për përfundimin e programit, ku puna dhe të gjitha dokumentet e Komisionit vlerësues të programit janë sekret zyrtar. Në të njëjtën kohë edhe Drejtoria për Mbrojtjen e Dëshmitarëve ka rolin e saj të madh e cila është organ i specializuar brenda Policisë së Kosovës dhe është përgjegjëse për zbatimin e masave për mbrojtjen e dëshmitarëve.

Ndërsa, prej hyrjes në fuqi të këtij ligji e deri në skadimin e mandatit të Misionit të EULEX-it në Kosovë, Komisioni dhe Drejtoria vendore për mbrojtjen e dëshmitarëve kanë përgjegjësi për mbrojtjen e dëshmitarëve në pajtim me këtë ligj, përveç nëse kërkesa për përfshirje në një program të EULEX-it për mbrojtjen e dëshmitarëve është paraqitur nga personat kompetent.

Financimi për zbatimin e këtij ligji sigurohet nga Buxheti i Republikës së Kosovës, por edhe nga burimet dhe programet ndërkombëtare, ndërsa përgjegjëse për zbatimin e këtij Ligji është Ministria e Punëve të Brendshme e cila brenda gjashtë muajsh pas hyrjes në fuqi të këtij Ligji, nxjerr aktet nënligjore për zbatimin e tij.

Miratohet Ndarja e Fondit Shtesë për stimulimin e Prokurorisë Speciale të Kosovës

• *Ky institucion ishte themeluar më 26 Shkurt 2010, me vendimin e Qeverisë.*

Në mbledhjen e 14-të të Qeverisë së Kosovës është miratuar ndarja e një fondi prej 130 mijë eurosh për stimulimin e prokurorëve të cilët punojnë në luftimin e korrupsionit dhe parandalimin e krimit të organizuar. Ky institucion ishte themeluar më 26 Shkurt 2010, me vendimin e Qeverisë për të përdorur të

gjithë stimuluesit financiar të nevojshëm për këta prokurorë, përfshirë edhe mbrojtjen fizike të tyre. Kryetari i këtij organi, që nga janari merr pagë në nivelin e kryeministrit, ndërsa prokurorët e gjyqtarët në nivel të ministrave. Propozimi për dhënie të fondeve shtesë për të stimuluar punën e

Prokurorisë speciale që merret me luftimin e korrupsionit dhe krimit të organizuar është aprovuar me sqarimin se kjo Prokurori ballafaqohet me një shkallë të lartë rreziku në natyrën delikate të punës që ata bëjnë. Kjo shumë është paraparë të ndahet nga Buxheti Rezervë i Qeverisë së Kosovës.

Miratohet kërkesa e MF për Ratifikimin e Konventës së Këshillit Botëror të Doganave

• *Përfundimi i procedurave për anëtarësim, do t'i mundësojë Doganave të Kosovës që kërkesa për anëtarësim në Organizatën Botërore të Doganave të shqyrtohet në sesionin e radhës të qershorit 2012.*

• *Në raportet e ndryshme ndërkombëtare, duke përfshirë edhe Raportet e Progresit të Komisionit Evropian, Kosova është kritikuar për mungesën e këtij ligji.*

Në mbledhjen e 13-të, të datës 29 prill, me vendimin 02/13, Qeveria miratoi kërkesën e Ministrisë së Financave për Ratifikimin e Konventës së Këshillit Botëror të Doganave. MF me qëllim të aplikimit për anëtarësim në Organizatën Botërore të Doganës (OBD), që nga viti 2009 ka punuar ngushtë me zyrtarë të lartë të kësaj organizate. Duke ditur rëndësinë e anëtarësimit në OBD, MF së bashku me Doganat e Kosovës kanë paraqitur kërkesën për aplikim në nëntor të viti 2009, ndërsa në janar të viti 2010 sekretari i OBD-së është përgjigjur pozitivisht, duke njoftuar me tutje procedurat e parapara në Konventën për themelimin e Këshillit për Bashkëpunim Doganor të vitit 1952. Sipas kësaj Konvente, kërkohet deponimi paraprak i instrumentit të Ratifikimit të Konventës për themelimin e Këshillit për Bashkëpunim Doganor. Instrumenti i Ratifikimit duhet të depozitohet në Ministrinë e Punëve të Jashtme të Belgjikës e cila

pastaj do ta dorëzojë tek organizata botërore për konsideratë nga trupi vendimmarrës.

Anëtarësimi në OBD, është i një rëndësie relevante sidomos në përfitimet e shumëfishta në zhvillimin e standardeve globale, thjeshtëzimin dhe harmonizimin e procedurave doganore, zinxhirin e sigurimit të tregtisë, lehtësimin e tregtisë ndërkombëtare, përmirësimin e aktiviteteve në pajtueshmëri me doganat tjera anëtare, ngritjen e iniciativave kundër falsifikimit dhe piraterisë, promovimin e integritetit, si dhe një sistem të qëndrueshëm doganor global.

Organizata Botërore e Doganave është një organizëm i pavarur ndërqeveritar që ka për mision rritjen e rezultatit dhe rendimentin e punës së administratave doganore nëpër botë. Dogana njihet si një institucion kyç për të arritur një qeverisje të mirë, prosperitet dhe mbrojtje për shoqërinë. Duke pasur parasysh

këtë gjë OBD ndihmon në rritjen ekonomike dhe mbrojtjen shoqërore të anëtarëve të vet nëpërmjet promovimit të një mjedisi doganor të ndershmë, transparent dhe të parashikueshëm. Kjo gjë lejon nga njëra anë rritjen e tregtisë ndërkombëtare të ligjshme dhe nga ana tjetër marrjen e masave kundër aktiviteteve ilegale.

OBD njihet ndërkombëtarisht si World Customs Organization (WCO) dhe përfaqëson të vetmen organizatë ndërqeveritare kompetente në çështjet doganore në të gjithë botën. OBD është themeluar më 26 Janar 1952 si Këshilli i Kooperimit Doganor dhe sot përfshin 169 qeveri anëtare.

Përfundimi i procedurave për anëtarësim, do t'i mundësojë Doganave të Kosovës që kërkesa për anëtarësim në Organizatën Botërore të Doganave të shqyrtohet në sesionin e radhës të qershorit 2012.



Edhe këtë vit Qeveria mbështeti manifestimet e Ditës Memoriale të Komunitetit Turk në Kosovë

• *Edhe në vendimin e vitit të kaluar por edhe në këtë vendim të fundit nuk është cekur fare marrësi i këtyre mjeteve, por vetëm xhirollogaria se ku janë derdhur në numër 21-12-0000131438-78 në Bankën Komerciale TEB.*

Me vendimin 05/11, Qeveria edhe këtë vit për herë të tretë mbështeti manifestimet që u zhvilluan për nderë të ditës memoriale të komunitetit turk, ku ndau 16.500 euro.

Ky është viti i tretë që Qeveria mbështet këtë manifestim që kur edhe u shpallë në Ligjin për Festat Zyrtare. Deri më tani janë ndarë gjithsej 66.776 euro, ku në vitin 2009 Qeveria pat ndarë mjete financiare në vlerë prej 35.276 euro, ndërsa në vitin 2010, 15.000 euro për mbulimin e shpenzimeve për festën memorial të komunitetit turk në Kosovë.

Të gjitha këto mjete për tri vite rresht u ndanë nga rezervat e Qeverisë, shpenzime të paparashikuara. Edhe në vendimin e vitit të kaluar por edhe në këtë vendim të fundit nuk është cekur fare marrësi i këtyre mjeteve, por vetëm xhirollogaria se ku janë derdhur në numër 21-12-0000131438-78 në Bankën Komerciale TEB.

Po ashtu, në vendim nuk theksohet asgjë edhe për rolin e Komisionit Republikan të Festave, i cili, sipas Ligjit për Festat Zyrtare, ka për detyrë që të përgatisë rregullat dhe mënyrat e festimit të festave

zyrtare dhe ditëve memoriale. Komisioni Republikan i Festave është formuar me vendimin e Qeverisë nr. 06/31, të 27 gushtit 2008.

Sipas Ligjit për Festat Zyrtare në Republikën e Kosovës, 23 prilli është Dita e Turqve. Por, nuk është festë zyrtare. Është Ditë Memoriale. Ashtu siç është 28 Nëntori – Dita e Shqiptarëve, 12 Qershori – Dita e Paqes; 8 Prilli – Dita e Romëve; 15 Shkurti – Dita e Ashkalinjve; 28 Shtatori – Dita e Boshnjakëve; dhe 6 Maji – Dita e Goranëve.

Për të dytin vit me radhë Qeveria përkrah Festivalin Ndërkombëtar të Poezisë "Drini Poetik"

• *Vitin e kaluar u ndanë 6.000 euro për për këtë festival.*

Në mbledhjen e 13-të, me vendimin 08/13, Qeveria miratoi kërkesën e Lidhjes së Shkrimtarëve për financimin e Festivalit Ndërkombëtar të Poezisë 'Drini Poetik' ku u ndanë mjete financiare në vlerë prej 12.590 euro. Ky është viti i dytë që Qeveria përkrahë këtë festival dhe zhvillohet nën patronatin e Kryeministrit të Republikës së Kosovës. Vitin e kaluar u ndanë 6.000 euro për për këtë festival.

Festivali ndërkombëtar i poezisë "Drini Poetik" do të mbahet për çdo vit, më 10-11 qershor, në qytetin e Prizrenit. Këtë vit në këtë Festival do të marrin pjesë poetë shqiptarë dhe të huaj. Festivali do të

kontribujë shumë për kontaktin kulturor kombëtar dhe afirmimin e Republikës së Kosovës. Agjenda e këtij manifestimi për këtë vit është paraparë të jetë si në vijim:

10 qershor 2011

- Hapja e Festivali të poezisë, më 10 qershor, ora 10 te LSHP;
- Ora e Lidhjes, ora 11-13;
- Ekspozita letrare & Për urim veprash letrare, ora 13-14;
- Vizita letrare në institucionet arsimore të komunës.
- Mbrëmja e poezisë me pika artistike, ora 18-20
- Çmimi Metafora (I, II e III) i Festivalit të poezisë.

11 qershor 2011

- Tryeza letrare, më 11 qershor, ora 11-13
- Tema: Si trajtohet letërsia shqipe sot?

Në këtë kuadër është planifikuar edhe botimi i një antologjie të poezisë bashkëkohore amerikane që do të botohet në dy gjuhë (anglisht e shqip) duke përfshirë dhjetë autorë. Tre nga këta poetë pritet që të jenë pjesëmarrës edhe në Festival.

Këto mjete do të ndahen nga rezervat e Qeverisë dhe do të bartën në xhirollogarinë e Lidhjes së Shkrimtarëve të Kosovës.

Përmbledhje

Më poshtë janë të radhitura të gjitha vendimet e marra nga Qeveria gjatë muajit prill 2011, ashtu siç janë marrë në formë kronologjike (mbledhjet 09–13):

1. Vendimet nga mbledhja 9 e Qeverisë së Kosovës, mbajtur me 08 prill 2011

1.1 Vendimi 02/09, Miratohet Projektligji për Mbrojtje nga Zjarri;

1.2 Vendimi 03/09, Miratohet Projektligji për Kontabilitet, Raportim Financiar dhe Auditim;

1.3 Vendimi 04/09, Miratohet Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr.2002/5 për themelimin e regjistrit të të drejtave të pronës së paluajtshme;

1.4 Vendimi 05/09, Miratohet Projektligji për Kadastër;

1.5 Vendimi 06/09, Miratohet Projektligji për Organizimin Sindikal në Kosovë;

1.6 Vendimi 07/09, Miratohet Projektligji për Këshillin Ekonomiko Social.

2. Vendimet nga mbledhja 10 e Qeverisë së Kosovës, mbajtur me 18 prill 2011

2.1 Vendimi 01/10, Miratohen Prioritetet e Zhvillimit Ekonomik

3. Vendimet nga mbledhja e 11 e Qeverisë së Kosovës, mbajtur me 20 prill 2011

3.1 Vendimi 02/11, Miratohet Projektligji për Ndihmë Juridike Falas;

3.2 Vendimi 03/11, Miratohet Projektligji për Mbrojtjen e Dëshmitarëve;

3.3 Vendimi 04/11, Miratohet Projektligji për Eficiencën e Energjisë;

3.4 Vendimi 05/11, Ndahen mjete financiare në shumë prej 16,500 euro për mbulimin e shpenzimeve për festën memoriale të komunitetit turk në Kosovë;

3.5 Vendimi 06/11, Miratohet rregullorja për Koordinim të Donatorëve.

4. Vendimet nga mbledhja 12 e Qeverisë së Kosovës, mbajtur me 27 prill 2011

4.1 Vendimi 02/12, Miratohet Projektligji për Sigurimin e Detyrueshëm nga Autopërgjegjësia ndaj Palëve të Treta;

4.2 Vendimi 03/12, Miratohet Projektligji për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr.02/L-8 për verërat;

4.3 Vendimi 04/12, Miratohet Projektligji për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-047 për Mbrojtjen dhe Promovimin e të Drejtave të Komuniteteve dhe Pjesëtarëve të tyre në republikën e Kosovës;

4.4 Vendimi 05/12, Miratohet shqyrtimi i mëtejme i kërkesës për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pronave të paluajtshme dhe zotëruesve të interesit të cilat ndodhen në zonat kadastrave Suharekë, Malishevë, Drenas dhe preken nga ndërtimi i autostradës në segmentin e 5të autostradës Vërmicë – Merdare, sipas tabelave të bashkangjitura këtij vendimi;

4.5 Vendimi 06/12, Miratohen shpronësimet shtesë, për interes publik, të pronarëve dhe zotëruesve të interesit në pronat e paluajtshme, të cilat preken nga ndërtimi i Autostradës Vërmicë- Merdare në segmentin nr.1 , nr. 2 dhe nr. 3 të autostradës;

4.6 Vendimi 07/12, Miratohen shpronësimet shtesë për interes publik, të pronarëve dhe zotëruesve të interesit në pronat e paluajtshme, të cilat preken në segmentin e 4 nga ndërtimi i autostradës Vërmicë - Merdarë;

4.7 Vendimi 08/12, iu vazhdohet pagesa 797 (shtatëqind e nëntëdhjetë e shtatë) ish-pjesëtarë të TMK-së, sipas listës së bashkangjitur me këtë vendim, prej muajit janar deri në qershor 2011, në shumën prej 50% të pagës bazë të cilën e kanë gëzuar deri me 31 maj 2010;

4.8 Vendimi 09/12, Miratohet Rishikimi i Dokumentit të Politikave për Kontrollin e Brendshëm të Financave Publike dhe Plani i Veprimit;

4.9 Vendimi 10/12, Miratohet Raporti tre mujor i Buxhetit për vitin 2011;

4.10 Vendimi 11/12, Miratohet kërkesa e MASHT-it për rritjen e pagave në

Institutin Albanologjik në shumë prej 171,330.29 për vit dhe në Institutin e Historisë në vlerë prej 93,809.90 për vit;

4.11 Vendimi 12/12, Miratohet kërkesa e MPJ-së për caktimin e zyrtarëve të Ministrisë së Punëve të Brendshme në Misionet Konsullore të Republikës së Kosovës;

4.12 Vendimi 13/12, Qeveria propozon Kuvendit për anëtar në Organin Shqyrtues të Prokurimit z. Osman Kryeziu.

5. Vendimet nga mbledhja 13-të e Qeverisë së Kosovës, mbajtur me 29 prill 2011

5.1 Vendimi 01/13, Miratohet Korniza Afatmesme e Shpenzimeve 2012 – 2014;

5.2 Vendimi 02/13, Miratohet kërkesa e Ministrisë për Financa për Ratifikimin e Konventës së Këshillit Botëror të Doganave;

5.3 Vendimi 03/13, Aprovohet kërkesa e Ministrisë së Financave për shtimin e listës të Aneksit A të Ligjit nr.03/L-220 për Normën e Tatimit të Akcizës në Kosovë ;

5.4 Vendimi 04/13, Qeveria e Kosovës themelon Këshillin Konsultativ për Drejtësi, si organ këshillëdhënës i Qeverisë në fushën e drejtësisë;

5.5 Vendimi 05/13, Themelohet Instituti për Hulumtimin e Krimeve të Luftës në Kosovë;

5.6 Vendimi 06/13, Të përgatitet studimi i arsyeshmërisë dhe të fillojnë procedurat për analizën e opsioneve kontraktuese për Operim dhe Mirëmbajtje të Autostradës Vërmicë – Merdare;

5.7 Vendimi 07/13, Të përgatitet studimi i arsyeshmërisë dhe të fillojnë procedurat për analizën e opsioneve kontraktuese për ndërtimin e Autostradës Prishtinë – Hani i Elezit;

5.8 Vendimi 08/13, Aprovohet kërkesa e Lidhjes së Shkrimtarëve të Kosovës për ndarjen e mjeteve financiare prej 12,590 euro për financimin e Festivalit “Drini Poetik”.

gap monitor

i vendimeve të Qeverisë së Kosovës

Rr. Nëna Terezë 41/29
10000 Prishtinë, Kosovë
+381 38 224 145
monitor@insitutigap.org
www.institutigap.org

"GAP Monitor" është projekt i Institutit për Studime të Avancuara GAP në të cilin monitorohen vendimet e Qeverisë së Kosovës. Projekti i "GAP Monitor" ka filluar në janar të 2009, ku përmes publikimeve të përmuajshme Instituti GAP i ofron publikut informata dhe analiza më të thella për të gjitha vendimet e Qeverisë së Kosovës. Tani, projektit të "GAP Monitor" është shtuar edhe faqja e re në internet, e cila na mundëson interaktivitet më të madh me lexuesit si dhe mundësinë për të publikuar lajme dhe analiza në kohë më të shpejtë.

INSTITUTI PËR STUDIME TË AVANCUARA



Instituti GAP është Think Tank kosovar, që punon në ngushtimin e hendekut në mes qeverisjes dhe qytetarëve të Kosovës, në shërbim të avancimit të shoqërisë kosovare.

Të gjitha raportet për vendimet e Qeverisë mund të gjenden edhe në portalin e GAP Monitor në internet www.gapmonitor.org

Instituti për Studime të Avancuara GAP
përkrahet nga:



Projekti i GAP Monitor
përkrahet nga:



Opinionet e shprehura në këtë dokument janë ato të Institutit GAP dhe jo medoemos reflektojnë pikëpamjet e donatorëve të këtij projekti.